

fq. 2

Hyn në fuqi Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"

fq. 2-3

Hyn në fuqi Ligji nr. 54/2014 datë 29.05.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572 datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" "

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2014 *fq.3-4*
- » Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30 qershor 2014 *fq. 6*
- » Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2014 *fq. 4-5*

ZHVILLIME TË TJERA

- » Zhvillohet takimi i rregullt ndërmjet AMF dhe FMA për mbikëqyrjen e grupeve austriake në Shqipëri *fq. 6-7*
- » Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare fillon zbatimin e projektit të asistencës për tregun e sigurimeve *fq. 7*
- » Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare fillon zbatimin e projektit të asistencës për tregun e pensioneve private vullnetare *fq. 8*
- » Seminar mbi tregjet e obligacioneve nga IOSCO *fq. 8-9*
- » Seminari i 10-të ndërkombëtar mbi çështjet thelbësore në mbikëqyrjen në sigurime *fq. 10*

LAJMET NGA RAJONI

- » Humbjet nga moti i keq në Evropë *fq. 11*
- » Greqi » Qipro » Rumani *fq. 12*

Hyn në fuqi Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”

Në datën 4 korrik 2014 hyri në fuqi Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Ligji vendos parimet dhe përcakton veprimtarinë dhe procedurat në lidhje me krijimin, organizimin, administrimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, në mënyrë që tregu i sigurimeve të funksionojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent. Ligji synon gjithashtu forcimin dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në sigurime.

Hyrja në fuqi dhe zbatimi në vazhdimësi i këtij ligji i shërben realizimit të synimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për të rritur më tej shkallën e përputhshmërisë dhe zbatimin e Parimeve Bazë të Sigurimeve (*Insurance Core Principles, ICP*) të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, IAIS, anëtare e së cilës është AMF.

Ligji i ri krijon hapësirë për aplikimin e mbikëqyrjes me fokus rrezikun, si një ndryshim në filozofinë aktuale të mbikëqyrjes në tregun e sigurimeve. Krahas zbatimit të këtij ligji të ri, AMF do të punojë edhe në plotësimin me akte të reja nënligjore.

Hyn në fuqi Ligji nr. 54/2014 datë 29.05.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572 datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare””

Në datën 17 korrik 2014 hyri në fuqi Ligji nr. 54/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572 datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare””. Ky ligj u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në 29 maj 2014. Ndryshimet dhe shtesat në këtë ligj synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në përmbushje të objektivave të tij, nëpërmjet forcimit të pavarësisë dhe të përgjegjshmërisë së AMF.

Ligji:

- Rivendos kompetencat e Bordit të AMF në lidhje me qeverisjen e institucionit, për të qenë në gjendje për t’iu përgjigjur me efektivitet procesit mbikëqyrës dhe rregullator, në mbështetje të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së tregjeve financiare;
- Forcon kërkesat për AMF në lidhje me marrëdhënien me autoritete të tjera mbikëqyrëse dhe ligjzbatuese për çështje të luftës kundër pastrimit të parave, të siguruara nga burime të paligjshme dhe financimit të terrorizmit;

- Qartëson mekanizmin mbrojtës për anëtarin e Bordit dhe të punonjësit të AMF-së gjatë ushtrimit të detyrës në mirëbesim, me synim forcimin e pavarësisë dhe integritetit të tyre në kryerjen e detyrës;
- Forcon pavarësinë dhe përgjegjshmërinë financiare të AMF-së duke parashikuar krijimin e fondit rezervë, duke specifikuar më qartë grumbullimin e të ardhurave dhe kthimin e tepricave në subjektet e mbikëqyrura, si dhe duke mos parashikuar financim nga buxheti i shtetit.

Hartimi i këtij projektligji u bë nga AMF në bashkëpunim me ekspertë të huaj nga Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare, (FSVC), si edhe duke mbajtur parasysh legjislationet e mjaft vendeve të tjera me tregje financiare të zhvilluara. Gjithashtu në hartimin e ligjit u mbajtën parasysh rekomandimet e dhëna nga Banka Botërore, Komisioni Evropian në raportet e progresit për Shqipërinë, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Programi për Vlerësimin e Stabilitetit Financiar 2013-2014. Ligji integron edhe parimet ndërkombëtare të hartuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime, (IAIS), Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë, (IOSCO), dhe Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS), të cilat e vënë theksin në pavarësinë politike, rregullatore, mbikëqyrëse dhe financiare/organizative të autoriteteve rregullatore të fushave përkatëse.

AMF u krijua në vitin 2006 si institucion publik i pavarur që rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë në tregjet financiare të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare në vend dhe raporton në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2014

Tregu i sigurimeve u rrit me 34.61% gjatë periudhës janar-qershor 2014. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 5.31 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me ulje të numrit të policave të sigurimit me 1.34% duke arritur në 447,244 polica.

Një tjetër tregues i ecursisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një ulje me 2.44% në krahasim me periudhën janar-qershor 2013. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.08 miliardë lekë, apo 82.11% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës, gjatë periudhës janar-qershor 2014, u rrit me 37.37% krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 2.87 miliardë lekë gjatë periudhës janar-qershor 2014, duke shënuar një rritje prej 70.18% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë kësaj periudhe raportuese përbën 54.20% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 16.95% të tregut të Jo-Jetës;
- sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 13.39% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 15.16% krahasuar me periudhën janar-qershor të vitit 2013. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” dhe përbën 53.67% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-qershor 2014

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.




Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2014

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2014 u dominua në masën 80.98% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*) dhe pjesa tjetër prej 19.02% ishin instrumente afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 93.63% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2014 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim”, përkatësisht me 62.91% dhe 21.64% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 97.71% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Letra me Vlerë të Qeverisë, Janar-Qershor 2014



- A- Blerje në tregun primar
- B- Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
- C- Blerje nga individët para afatit të maturimit
- D- Vendosije e bonos si kolateral
- E- Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit **B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar”** gjatë periudhës janar-qershor 2014, ka pasur një rritje prej 203 milionë lekë ose 7.37% krahasuar me periudhën janar-qershor 2013, ndërsa është ulur numri i transaksioneve në masën 9.52%.

Transaksioni i llojit **C “Blerje nga individët para afatit të maturimit”** gjatë periudhës janar-qershor 2014 ka pasur një ulje prej 169 milionë lekë ose 11.16% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013. Kjo është shoqëruar edhe me ulje të numrit të transaksioneve në masën 9.82%.

Krahasuar me periudhën janar-qershor 2013, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 34 milionë lekë

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale		Ndryshimi
	(Në mln. lekë)		(Në %)
Janar-Qershor	2013	2014	'14/'13-1
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	2,760.14	2,963.58	7.37
<i>Individë</i>	2,714.98	2,601.92	(4.16)
<i>Persona juridikë</i>	45.16	361.66	700.79
C Blerje nga individët para afatit të maturimit	1,515.69	1,346.51	(11.16)
<i>Individë</i>	1,315.69	1,126.45	(14.38)
<i>Persona juridikë</i>	200.00	220.06	10.03

Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30 qershor 2014

Gjatë periudhës janar-qershor 2014, në tregun e Fondeve të Investimeve ushtruan aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve "Raiffeisen Prestigj" dhe Fondi i Investimeve "Raiffeisen Invest Euro".

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve në 30.06.2014, vlera neto e asetëve të Fondeve arriti mbi 65.07 miliardë lekë me një rritje prej 29.29% krahasuar me 31.12.2013.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare të cilët përbëjnë 79.29% të asetëve të fondeve, me rritje prej 22.04% krahasuar me 31.12.2013.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 30.06.2014 është 34,885.

ZHVILLIME TË TJERA

Zhvillohet takimi i rregullt ndërmjet AMF dhe FMA për mbikëqyrjen e grupeve austriake në Shqipëri

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA), një delegacion nga ky institucion, i kryesuar nga Z. Peter Braumüller, zhvilloi një takim pune në datën 11 korrik 2014, pranë zyrave të AMF-së me znj. Enkeleda Shehi, kryetare e AMF-së. Z. Braumüller është drejtor i institucionit homolog austriak për Mbikëqyrjen e Tregut të Sigurimeve dhe njëkohësisht anëtar i Bordit të EIOPA (Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale) dhe Kryetar i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime.

Bashkëpunimi me FMA-në e Austrisë tashmë është i konsoliduar, gjë që është materializuar me takime të shpeshta të drejtuesve të lartë të institucioneve si dhe stafëve teknike. Prej vitit 2009, të dy institucionet kanë një marrëveshje mirëkuptimi, e lidhur menjëherë pas investimeve të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri. Mbi këtë bazë janë ndërtuar marrëdhënie tepër efektive ndërmjet dy institucioneve, duke u konkretizuar me shkëmbim përvojë dhe punë të përbashkët në mbikëqyrjen e grupeve austriake që operojnë në Shqipëri. Me ftesë të FMA, AMF është tashmë pjesëmarrëse e rregullt e kolegjeve mbikëqyrëse për këto grupe.

Në takimin e sotëm u diskutuan çështje të rëndësishme, që lidhen me zhvillimet e fundit të vlerësimit të sistemit financiar në juridiksionet respektive (FSAP), ndryshimeve strukturore të të dy autoriteteve rregullatore, zhvillimet ligjore e të mbikëqyrjes së grupeve, si dhe fushat më imediate të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Po kështu, u diskutuan çështje të përbashkëta për mbikëqyrjen e grupeve austriake të sigurimeve, të cilat kanë prezencë dominuese në tregun shqiptar të sigurimeve, proces ky që koordinohet tashmë në nivel rajonal nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare të Austrisë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare fillon zbatimin e projektit të asistencës për tregun e sigurimeve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet First Initiative (Financial Sector Reform and Strengthening Initiative) filloi zbatimin e projektit të asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve. Objektivi i këtij projekti është të ndihmojë AMF-në në përmbushjen e reformave ligjore dhe rregullatore për të forcuar mbikëqyrjen dhe rregullimin e sektorit të sigurimeve dhe për të mundësuar zhvillimin e produkteve të sigurimit nga tërmetet.

Projekti përqendrohet në tre komponentë bazë që janë:

- Rishikimi i kuadrit rregullator për produktet e sigurimit MTPL me theks të veçantë mbi teknikat e përlllogaritjes së provigjoneve të dëmeve nga produktet e sigurimit MTPL;
- Rishikimi i kuadrit të përgjithshëm mbikëqyrës me theks të veçantë ndërtimin e manualeve tematike të inspektimit, si dhe plotësimin e kuadrit rregullator në funksion të ligjit të ri, i cili parashikon mbikëqyrjen me bazë risku;
- Dizajnimi dhe zhvillimi i një programi kombëtar për sigurimin nga tërmetet.

Projekti i asistencës ka një shtrirje kohore prej 24 muajsh dhe pritet të përfundojë në vitin 2016. Java 4-10 korrik 2014 shënon fillimin e projektit. Gjatë kësaj jave grupi i ekspertëve të Bankës Botërore i përbërë nga z. Eugene Gurenko dhe znj. Alma Qamo shqyrtuan me stafin e AMF-së dhe palë të tjera të interesuara, si shoqëri sigurimesh dhe institucione shtetërore kushtet për të nxitur reformën e tregut të sigurimeve.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare fillon zbatimin e projektit të asistencës për tregun e pensioneve private vullnetare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet *First Initiative (Financial Sector Reform and Strengthening Initiative)* filloi zbatimin e projektit të asistencës teknike për mbikëqyrjen dhe zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare në vend. Objektivi i këtij projekti është mbështetja e zgjerimit të procesit të rregullimit dhe mbikëqyrjes së pensioneve private, si dhe të kontribuohet në zgjerimin e shtrirjes së tregut të pensioneve private në një sistem pensionesh më të sigurt, të qëndrueshëm dhe të efektshëm.

Projekti përqendrohet në dy komponentë bazë që janë rregullimi dhe mbikëqyrja, si dhe zgjerimi i tregut, duke kontribuar në ndërtimin e kuadrit të mbikëqyrjes mbi bazë risku dhe të kapaciteteve mbikëqyrëse; rishikimin e bazës ligjore dhe rregullatore për të mbështetur kuadrin e ri mbikëqyrës; apo përcaktimin e një plani strategjik dhe veprimi për të mbështetur zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare.

Projekti i asistencës ka një shtrirje kohore prej 18 muajsh dhe pritet të përfundojë në vitin 2015. Java 7-11 korrik 2014 shënon fillimin e projektit. Gjatë kësaj jave grupi i ekspertëve të Bankës Botërore i përbërë nga z. William Price, z. John Ashcroft dhe z. Leendert Van Driel shqyrtuan me stafin e AMF-së dhe palë të tjera të interesuara, si shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve, institucionet shtetërore dhe bizneset, potencialin dhe kushtet për të nxitur zhvillimin e tregut të pensioneve.

Seminar mbi tregjet e obligacioneve nga IOSCO

Në datat 1 dhe 2 korrik 2014, në Romë u zhvillua seminari mbi tregjet e obligacioneve të korporatave i organizuar nga Komiteti për Rajonin e Evropës, IOSCO (Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë), në bashkëpunim me Komisionin Italian të Letrave me Vlerë dhe Bursave (CONSOB). Në seminar u theksua rëndësia e zhvillimit të tregut të obligacioneve dhe roli i këtij tregu, si burim financimi për biznesin.

Rëndësia e zhvillimit të tregjeve të obligacioneve, sidomos të obligacioneve në monedhën lokale të çdo vendi, është theksuar që në vitin 2011 nga Samiti i G-20 nëpërmjet "Planit të veprimit për zhvillimin e tregjeve të obligacioneve të korporatave".

Për vendet në zhvillim, zhvillimi i tregjeve të obligacioneve vendase përbën një nga prioritetet e rëndësishme për të diversifikuar mjetet e financimit, përtej financimit nga sektori bankar dhe tregu i aksioneve. Kriza financiare i bëri bankat më konservatore në dhënien e kredive, e shoqëruar kjo nga masa të forta rregullative, siç janë kërkesat e Basel III. Në këto kushte, vendet me një treg më aktiv të obligacioneve vendase treguan se ishin më të afta të përballonin reduktimin e financimit nga sektori bankar.

Gjithashtu, tregu i obligacioneve i ndihmon korporatat të ulin koston e financimit, nga ana tjetër një treg obligacionesh aktiv dhe efektiv i ofron kursimtarëve mundësi për të investuar në një spektër më të gjerë asetesh. Tregjet e obligacioneve përmirësojnë transparencën dhe menaxhimin e kompanive duke inkurajuar transparencë më të madhe, duke i nxitur kompanitë të jenë më të hapura ndaj publikut, duke i detyruar ato të kuptojnë më mirë veten dhe si rrjedhojë të përmirësojnë menaxhimin e tyre.

Seminari, përveçse tregoi përfitimet dhe nevojën e zhvillimit të tregut të obligacioneve të korporatave, e vuri theksin tek tiparet e këtij tregu që janë: mungesa e likuiditetit, tendenca e investitorëve për të blerë obligacione dhe për t'i mbajtur ato, risk dhe yield më i lartë i obligacioneve të korporatave në krahasim me obligacionet e qeverisë, tendenca konservatore e investitorëve për tregjet e obligacioneve, apatia e tregjeve sekondare, si dhe orientimi i tregut të obligacioneve më tepër drejt investitorëve institucionalë.

Eksperiencia italiane mbi zhvillimin e tregjeve të obligacioneve zuri vend të rëndësishëm në seminar. Përfaqësuesja e Departamentit të Thesarit italian pranë Ministrisë së Financave ofroi për auditorin eksperiencën në menaxhimin e borxhit publik, duke dhënë një panoramë të qartë të strategjive në lidhje me tregun primar dhe tregun sekondar të obligacioneve të emetuara nga qeveria. Përfaqësuesi i Euro TLX, një platformë e tregimit të obligacioneve të korporatave në Itali, tregoi se në këtë platformë tregtohen në mënyrë aktive të gjitha tipet e obligacioneve, dhe se karakteristikë e këtij tregu është se ai përfaqëson segmentin e tregut me pakicë. Përfaqësuesi i platformës Banka IMI Market Hub tregoi se kjo platformë ofron një nga zgjidhjet më të avancuara në lidhje me aksesin e integruar të tregjeve financiare dhe mbështetet në parimin e ekzekutimit më të mirë, si për aksionet, ashtu edhe për obligacionet. Kjo platformë është e dedikuar për investitorët institucionalë.

Për rëndësinë që paraqet zhvillimi i tregut të obligacioneve, Direktiva e MiFID2, (*Markets in Financial Instruments Directive*) e cila hyri në fuqi më 2 korrik 2014, parashtrohet një sërë rregullimesh për tregun e obligacioneve dhe i shtrin kërkesat për transparencë para dhe pas tregimit si për aksionet ashtu edhe për obligacionet. Gjithashtu, MiFIR (*Markets in Financial Instruments Regulation*) përcakton kriteret për likuiditetin e obligacioneve që lidhen me: madhësinë e transaksionit, frekuencën e transaksionit, numrin dhe tipet e pjesëmarrësve të tregut, diferencën mes çmimit të ofruar dhe të kërkuar.*

Gjatë seminarit u vu në dukje se tregu i obligacioneve, mbështetur në rëndësinë e tij, duhet të stimulohet. Ai shërben si burim financimi edhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Bazë për zhvillimin e tregut të obligacioneve të korporatave është zhvillimi i tregut primar dhe sekondar të obligacioneve të qeverisë, si dhe stimulimi i ofertave private të obligacioneve të korporatave.

Në këtë seminar u përfaqësua edhe AMF. Konkluzionet e dala nga seminari janë të vlefshme edhe për kushtet e zhvillimit të tregut të obligacioneve në Shqipëri.

*Direktiva për Tregjet në Instrumentet Financiare (*Markets in Financial Instruments Directive, MiFID*) është një nga ligjet e shumta Bashkimi Evropian e ka zhvilluar në lidhje me tregjet financiare dhe kompanitë, fondet dhe bankat që janë aktive në këto tregje. MiFID është një nga ligjet më të rëndësishme, pasi ajo në përgjithësi mbulon të gjitha llojet e instrumenteve financiare dhe gjithashtu një gamë të gjerë aktorësh pjesëmarrës në këto tregje.

Seminar i 10-të ndërkombëtar mbi çështjet thelbësore në mbikëqyrjen në sigurime

Instituti për Stabilitet Financiar (FSI), zhvilloi gjatë periudhës 29 qershor deri 4 korrik 2014, në Beatenberg, Zvicër, seminarin e 10-të ndërkombëtar mbi çështjet thelbësore të mbikëqyrjes së sigurimeve, me pjesëmarrës nga vende të ndryshme. Seminari u zhvillua në formën e një tryeze të rrumbullakët me diskutime në grup, shkëmbim idesh e perspektivash lidhur me mbikëqyrjen. Ai u përqendrua në trajtimin e disa prej çështjeve thelbësore të mbikëqyrjes siç ishin:

1. Roli i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) dhe i standardeve ndërkombëtare;
2. Mbikëqyrja me fokus makro dhe risku sistemik;
3. Menaxhimi i riskut dhe roli i risigurimit;
4. Kapitali (Solvency) dhe metodat cilësore dhe sasiore të vlerësimit të riskut të sigurimeve;
5. Mbikëqyrja në nivel grupi dhe bashkëpunimi i rregullatorëve të shteteve ku ushtron aktivitet grupi;
6. Vlerësimi i provigjoneve teknike bazuar në standardet e IAIS dhe qasja bazuar në bilanc shoqëruar me shembuj konkretë;
7. Mësimet e dala nga kriza financiare dhe roli i qeverisjes së korporatave;
8. Menaxhimi i riskut së korporatave dhe përlllogaritja e kapitalit rregullator me qasje riskun.

Temat kryesore, u prezantuan nga drejtues të nivelit të lartë të FSI dhe IAIS, si dhe profesionistë të tjerë të fushës. Secila prej temave të trajtuara ndiqej nga një rast studimor, i cili diskutohej dhe prezantohej nga pjesëmarrësit, të cilët ishin të ndarë në grupe pune. Ndër temat që u analizuan dhe u prezantuan nga pjesëmarrësit ishin:

- Rast studimor lidhur me kriteret e liçencimit të një shoqërie sigurimi;
- Rast studimor lidhur me mbikëqyrjen e grupit ku u theksuan mjaftueshmëria e kapitalit të grupit, qeverisja e tij dhe menaxhimi i riskut në nivel grupi;
- Rast studimor mbi identifikimin e hershëm të shoqërive të sigurimit me paqëndrueshmëri financiare dhe analizimin e shkaqeve si pasojë e së cilave një shoqëri sigurimi rrezikon falimentimin.

Lektori përfaqësues i Autoritetit Mbikëqyrës Australian (APRA) prezantoi rastin e falimentimit të kompanisë së dytë më të madhe të sigurimit në Australi, HIH, i konsideruar si falimentimi më i madh në historinë e Australisë. Pjesëmarrësit të organizuar në grupe pune, në përfundim të seminarit realizuan një sërë prezantimesh rreth çështjeve të ndryshme të procesit të mbikëqyrjes, si mbikëqyrja me bazë risku dhe me fokus makro.

Humbjet nga moti i keq në Evropë

www.xprim.com

Gjysma e parë e vitit 2014 solli shpenzime të mëdha në Evropë, kjo pasi gjatë kësaj periudhe pati disa ditë me mot të ashpër, stuhi dimri, shira të furishëm dhe stuhi gjatë pranverës që shkaktuan dëme të mëdha ekonomike që arritën në më shumë se 10.8 miliardë dollarë në humbje ekonomike. Sipas Raportit të qershor 2014 raportuar nga AON BENFIELD, rreth 53% e humbjeve ekonomike janë regjistruar në Evropën Perëndimore, edhe pse në aspektin e viktimave njerëzore, Evropa Qendrore dhe Lindore u godit më shumë. (AON BENFIELD është një ndër ndërmjetësit kryesorë në botë për risigurimin dhe firmë këshillimore për tregjet financiare.)

Kështu, sipas Raportit, humbjet ekonomike të regjistruara në Evropën Perëndimore gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2014 tejkaluan 5.75 miliardë USD. Ndërsa në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, edhe pse për ngjarjet e motit të keq në raportin AON BENFIELD nuk ka vlerësime përfundimtare, totali i humbjeve ekonomike me përafërsi llogaritet në një volum deri në 5 miliardë dollarë. Numri i viktimave njerëzore në Evropën Qendrore dhe Lindore ishte rreth 100 persona, ndërsa në vendet perëndimore ishte 10-12 persona.

Ngjarja më e vështirë në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore është regjistruar në gjysmës së dytë të muajit maj, kur shirat më të rrëmbyeshëm që kanë rënë në 120 vitet e fundit shkaktuan përmytje të mëdha në Serbi dhe Bosnje. Shirat çuan edhe në rrëshqitje të tokës. Lumenj të tejmbushur përmytën më shumë se 100.000 shtëpi, vetëm në Bosnje, duke shkaktuar evakuime masive në pjesë të tjera të Ballkanit. Zyrtarët deklaruan se këto janë ngjarje që mund të ndodhin 1 në 100 vjet, pasi një e treta e të gjithë shumës vjetore e reshjeve u regjistrua në pak ditë. Përveç dëmtimit të pronës edhe aktivitetet tregtare, bujqësore dhe infrastruktura u dëmtuan rëndë. Humbjet ekonomike vlerësohen të jenë afër 3.3 miliardë euro, edhe pse humbjet e siguruarat ishin shumë më pak duke pasur parasysh normat e ulëta të depërtimit.

GREQI

www.xprimm.com

Sipas raportit për tremujorin e parë të viti 2014, botuar nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimit (HAIC), siguruesit grekë raportuan një volum të primeve të shkruara bruto prej afro 986 milionë euro në tremujorin e parë të vitit 2014, në krahasim me 1.01 miliardë euro të realizuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Raporti jep të dhëna për 59 kompani të sigurimit të cilat zënë 94.6% të totalit të tregut, nga të cilat 21 ishin aktive në segmentin e Jetës (98.7% të tregut) dhe 49 ishin aktive në segmentin e Jo-Jetës (91.3% të tregut).

Kështu, në periudhën e analizuar, primet e sigurimit të Jo-Jetës përbënin 57.3% të totalit të primeve të sigurimit, 565 milionë euro, ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës llogaritet për pjesën e mbetur të tregut, 421 milionë euro.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros, tregu i sigurimeve në vend realizoi një volum të primeve të shkruara bruto prej rreth 196 milionë euro në tremujorin e parë të vitit 2014, duke pasqyruar një rënie vjetore prej 6.3%. Në segmentin e sigurimit të Jetës, tregu lokal pati një dinamikë negative me rënie prej 9.7% në nivel vjetor, duke arritur në afro 80 milionë euro. Ndërsa segmenti i sigurimit të Jo-Jetës është ulur me 3.9% në nivel vjetor dhe arriti në 116 milionë euro.

Dëmet e paguara, në tremujorin e parë të vitit 2014, arritën në rreth 117.5 milionë euro krahasuar me 144.6 milionë euro që ishin në tremujorin e parë të vitit 2013. Pjesa më e madhe e dëmeve i takonte sigurimit të Jetës.

RUMANI

www.xprimm.com

Sipas raportit vjetor të publikuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë, tregu rumun i sigurimeve gjatë vitit 2013 regjistroi një humbje rekord në vlerën e afro 1.28 miliardë RON (monedha e vendit Leu) ose e shprehur në euro rreth 290.52 milionë. Të dhënat tregojnë se deri më 31 dhjetor 2013, 17 kompani sigurimesh regjistruan rezultate pozitive, fitime neto, ndërsa 20 kompani të tjera raportuan humbje.